

24.07.2023

**PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

OBJEKTI I PROCEDURËS: Blerje Kancelari

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Toner per printer lazer /makina fax

Stilolapsa

Lapsa

Kapese letrash

Mbajtës për kapese letrash

VLERA E FONDIT LIMIT : 2,000,000 (dy milion) lekë, pa tvsh., vënë në dispozicion nga te ardhurat e veta

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Ujësjellës Kanalizime Kamëz sh.a** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT PËR TË DYJA LOTET**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të L.PP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

## **2.2.1 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1 Vërtetim nga Dega e Tatimeve për xhiron vjetore të realizuar gjate 3 (tre) viteve te fundit financiare (2020, 2021 dhe 2022) ku vlera mesatare e tyre te jete jo me e vogel se vlera e fondit limit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Autoriteti Kontraktor i është referuar VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 43, pika 2, gërma a) dhe vlerën e xhiros minimale vjetore e ka përcaktuar brenda kufirit maksimal të lejuar nga ky nen.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021, 2022 të konfirmuara nga Organet tatimore shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar (vetëm në rastin kur janë objekt i nenshktrimit te auditimit), ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, të nenit 41 të Ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

## **2.3 Kapaciteti profesional dhe teknik**

### **Kapaciteti profesional**

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate përkatësisht 400,000(katërqind mijë) lekë pa tvsh.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara ose
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Kriteri i vendosur tregon që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që vlera totale e kontratave//kontratës të mëparshme, të ngjashme, të realizuara gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, të jetë jo më e vogël se 15 % e vlerës së përllogaritur të fondit limit për lotin / shumatoren e loteve për të cilat konkurron.

### **Kapaciteti teknik**

2.3.2 Nisur nga rëndësia operatori ekonomik duhet të jetë i certifikuar:

1.Me certifikate te menaxhimit te cilësisë ISO 9001-2015 që i referohet objektit të prokurimit.

- Certifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë (e përkthyer e noterizuar)

**Argumentim:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin të 36 dhe 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe neneve 40, pika 8, dhe 44, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mundësitë për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

AK, bazuar në dispozitat më sipër cituar dhe kërkesat e specifikimeve teknike, dhe preventivit të furnizimeve, ka kërkuar paraqitjen e dokumentacionit (Certifikatat ISO) dëshmues të pajtueshmërisë së ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit. Certifikatat ISO të kërkuara nga AK lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës dhe specifikën e furnizimit të shtjelluara dhe zgjidhura në preventivin përkatës.

Në vijim shtjellohen certifikatat ISO të kërkuara nga AK.

**ISO 9001:2015.** Që një subjekt të jetë i pajisur me certifikatën ISO 9001, do të thotë se ky subjekt ka plotësuar kërkesat e këtij standardi mbi ”Sistemet e menaxhimit të cilësisë”. ISO 9001:2015 specifikon kërkesat për një sistem cilësor të menaxhimit të cilësisë, kur një organizatë:

- duhet të dëshmojë kapacitetin për të siguruar vazhdimisht produktin që kënaq klientin dhe kërkesat statutorë dhe normative të aplikueshme.
- synon të përmirësojë kënaqjen e klientit, nëpërmjet aplikimit të sistemit, duke përfshirë proceset për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit dhe garancisë të konformitetit me klientin dhe kërkesat statutorë dhe normative të aplikueshme.

2.3.3. Per artikullin Letër format A4 e bardhe 80gr/m<sup>2</sup>, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Vërtetim/Deklaratë/Autorizim (të përkthyer dhe të noterizuar) për specifikimet teknike nga prodhuesi, ku të gjejnë pasqyrim specifikimet teknike.

**Argumentim:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar nënën të 36, dhe 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nënën 40, pika 6 dhe 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Paraqitja e autorizimit të prodhuesit ose vërtetimit ose dokumentit ose autorizimit të distributorit të autorizuar për furnizimin e mallrave që do të ofertohen, është kërkesë e ligjore e domosdoshme, me qëllim që OE të kenë autorizimin për tregtimin e produkteve nga prodhuesi apo distributori i autorizuar, duke ofruar dhe garanci për mallrat që do të furnizohen.

Për nga vetë natyra e veçante e procedurës së prokurimit, me qëllim realizimin e kontratës që prokurohet, kriteri i sipërcituar është një kërkesë e nevojshme që lidhet drejtpërdrejt me rëndësinë dhe natyrën e objektit që prokurohet dhe që mund të plotësohet nga çdo operator ekonomik, cili ka kapacitetet e nevojshme për realizimin e procedurës.

2.3.4 . Per tonerat Operatori ekonomik ofertues (*nese nuk eshte prodhues*) duhet te paraqes autorizim nga prodhuesi ose nga distributori zyrtar i autorizuar nga prodhuesi (*ku të provohet/dokumentohet lidhja e tyre me prodhuesin*), nëpërmjet të cilit konfirmohet se ofertuesi autorizohet të tregtojë artikujt objekt prokurimi. Autorizimi duhet të jetë original ose kopje e përkthyer dhe noterizuar si dhe i vlefshëm në momentin e hapjes së ofertave.

**Argumentim:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nënën 77, pika 4, të ligjit nr 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe nënën 40, pika 8, të vendimit nr.285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Nisur nga fakti që OE ofertues mund të mos jenë detyrimisht prodhues të mallit por mund a sigurojnë mallin nga këta të fundit ose distributorë të autorizuar prej tyre ndaj është kërkuar autorizimi për të provuar lidhjen ndërmjet ofertuesit dhe prodhuesit .

2.3.5. Ditën dhe orën e hapjes së ofertave, ofertuesi duhet të dorëzojë në zyrën e protokollit të UKK sh.a, mostra të artikujve me nr. rendor 3,5,6,8,18,25,49,64,65,67,69,73,74 sipas specifikimeve të kërkuara në dokumentat bashkelidhur SPE.

*Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit;*

**Kujdes:**

**Mosdorëzimi i mostrave të këtyre produkteve përbën kusht s’kualifikues.**

*Argumentimi:* Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe nenin 40, pika 6, germa a, të vendimit nr.285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Për shkak se artikujt e kerkuar do te perdoren per procesin zgjedhor, duke u shperndare ne te gjithë territorin e vendit per te mos pasur problematika dhe pamundesit per te ndryshuar mallarat e shperndare per komisionet zonale eshte kerkuar paraprakisht dorezimi i mostrave.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

- **SPECIFIKIMET TEKNIKE**

Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës, është bërë nga grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlllogaritjen e fondit limit. Fondi Limit i kësaj procedure është bazuar në testimine e tregut dhe kontratat e mëparshme.

Specifikimet teknike janë vendosur nga grupi i punës duke ju referuar qellimit për të cilin do të përdoren artikujt.

Specifikimet e tonerave janë vendosur duke pasur ne konsiderate tipet e pajisjeve multifunksionave qe institucioni yne ka në përdorim.